

Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm për të huajin, të cilit në Republikën e Sllovenisë i lejohet lëvizja, duhet bashkëlidhur:

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë, nëse disponon me to;
- dëshminë mbi arsyet eventuale të bazuara dhe rrethanave tjera të veçanta, të cilat bazojnë qëndrimin në Republikën e Sllovenisë;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon.

Në procedurën njësia administrative sipas detyrës zyrtare do ti siguroi të dhënat në vijim:

- mbi lejimin e lëvizjes në Republikën e Sllovenisë;
- nga evidenca penale, evidenca e aktgjyqimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjyqimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente.

Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajit;
- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkuara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkontë ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkuara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajit;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: dpo.mnz@gov.si;
- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit.